


# KËSHILLA PËR NXËNËSIN E DITURISË



**SALIH IBËN ABDULAZIZ ALI SHEJH**

# KËSHILLA

PËR NXËNËSIN E DITURISË

SALIH ALI SHEJH

MINISTËR I ÇËSHTJEVE ISLAME, VAKËFEVE,  
THIRRJES DHE ORIENTIMIT

Titulli original: الوصايا الجلية للاستفادة من الدروس العلمية

El uasaje el xhelijetu lil istifedeti min ed-durusil ilmijeti

Titulli i plotë: Këshilla fisnike për të përfituar nga mësimet akademike

Autor: Salih ibën AbdulAziz Ali Shejh

Përktheu: Besmir Cacani

Publikimi në web: [www.revistamedina.net](http://www.revistamedina.net)

© të gjitha të drejtat janë të rezervuara për përkthyesin

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

## **HYRJE**

Lavdi Allahut, Zotit të krijesave, i Cili i ka dhënë sukses atyre që ka dashur për tek rrugët e kënaqësisë së Tij, ka mësuar kë ka dashur dhe ka edukuar ata që i ka përzgjedhur.

Atij i takon lavdia për mirësitë e panumërta që na ka dhënë dhe për dhuntitë e shumta. Për Allahun janë lavditë e shumta, ashtu siç ka dhuruar mirësi të shumta. Falenderimet e shumta janë për Allahun, ashtu siç na ka dhuruar mirësi në mengjes dhe mbrëmje.

Lavditë dhe falenderimet qofshin për Allahun, Atë e lavdëroj me gjitha të bukurat.

Dëshmoj se nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut, të Vetëm e të pashok, po ashtu dëshmoj se Muhamedi është robi dhe i Dërguari i Tij. Salavatet dhe selamet e shumta qofshin mbi të, familjen dhe shokët e tij.

E lus Allahun xhel-le ue ala që të më bëjë mua dhe ju, prej atyre që punojnë vepra që Ai i do dhe është i kënaqur, që të na lehtësojë të gjithëve rrugët e të mirës, e të na mbyllë të gjitha rrugët e të keqes, me të vërtetë Ai është Dhurues dhe Bujar.

Më pas: jam në hapje të këtyre mësimeve akademike, që është seminari i gjashtë në xhaminë Shejhul Islam Ibën Tejmije, në lagjen Sulltan, në qytetin e Rijadit. Unë duhet patjetër t'i drejtohem Allahut azze ue xhel-le e të lutem për ata që i kanë organizuar këto seminare dhe mësime akademike.

E lus Allahun xhel-le ue ala që t'i shpërblejë me të mira, t'ia shtojë ndihmën e të vërtetës, thirrjen për tek ajo, hapjen e portave të së mirës dhe afrimit për tek Allahu xhel-le ue ala. Kjo është prej obligimeve që duhet të angazhohemi me to.

Këto seminare organizohen çdo vit dhe përfshijnë mësim në lëndë dhe lëmi të ndryshme.

Saminari zgjat tre jave dhe përmban tetëmbëdhjetë mësim, në lëndë të ndryshme. Me dëshirën e Allahut të Lartësuar, do të arrini dituri të shumta gjatë kësaj kohe të shkurtër.

Disa vëllezër kanë zgjedhur që titulli i kësaj ligjërate, e cila është edhe hapja e seminarit, të jetë: **Porosi të qarta për të përfituar nga mësimet akademike.**

Nga përvoja ime e shkurtër në seminare të mëhershme, dhe nga dija që kam lidhur me frytet që kanë dhënë seminare, them:

Çdo seminar apo mësim akademik, duhet të ketë patjetër disa shtylla mbi të cilat të ngrihet.

#### **Ato shtylla janë katër:**

**E para:** organizimi i përshtatshëm që bëhet para mësimve akademike.

**E dyta:** prezenca e mësuesit (dijetarit).

**E treta:** prezenca e studentëve seriozë që kanë dëshirë.

**E katërta:** gjendja e një vendi të përshtatshëm për organizimin e seminareve që do t'i prezantojnë një numër i madh, për një kohë të shkurtër.

## SHTYLLA E PARË: ORGANIZIMI I PËRSHTATSHËM

Padyshim, përfitimi i madh nga këto mësimë varet edhe nga organizimi i mirë dhe parapërgatitja. Në këtë mënyrë arrihet përfitimi prej këtyre seminareve dhe mësimëve.

Organizimi është përgatitja e gjendjes së përshtatshme për këto mësimë.

**Organizatorët janë:** imami i xhamisë, ose vëllezër që veprojnë në Drejtorinë e Thirrjes, apo në Qendren e Thirrjes.

Organizatori duhet të shikojë patjetër për nevojën që kanë nxënësit e dijes, nevojën që ka rinia, të cilët po synohen nga këto mësimë.

Kjo nevojë ndryshon me ndryshimin e vendit dhe kohës, po ashtu me ndryshimin e mësuesve dhe librat që do të mësojnë nxënësit.

Në kohën tonë, ndryshojnë seminarët e dimrit nga ato të verës, në organizim dhe kohë.

Nuk është e thënë që çdo kush që dëshiron të organizojë një seminar apo disa mësimë akademike, nuk është e thënë se është e përshtatshme ta organizojë në xhaminë e tij, sepse ato do të prezantohen nga një numër i madh i nxënësve që dëshirojnë të përfitojnë.

Kjo të bën të përgatisësh një vend , që të jetë i përshtatshëm nga një aspekt, të ketë kondicionerë nga një aspekt tjetër, të jetë e lehtë hyrja dhe dalja nga një aspekt tjetër.

Patjetër duhet kujdesur për gjendjen, vendin dhe kohën.

Pastaj, organizatorët si fillim duhet të kujdesen që organizimin dhe përgatitjen e seminarit ta bëjnë shumë kohë përpara.

Përgatitja me dijetarët duhet të jetë gjashtë muaj përpara, apo pesë, apo katër muaj, në mënyrë që ata të përgatiten.

Ka ndodhur që disa vëllezër kanë dashur të organizojnë mësimet dhe seminare, e janë përpjekur që t'i bindin disa dijetarë për të marrë pjesë dy javë para, apo tre, apo një muaj. Dijetarët nuk kanë qenë dakort, sepse janë të lidhur me obligime të tjera që i pengojnë nga përgjigjja e ftesës, sidomos gjatë kohës së pushimeve, në të cilat bëhen shumë organizime.

Pra, zgjedhjet bëhen para një kohe të mjaftueshme, që të bëhet i mundur oraganizimi me të gjithë dhe të arrihet përzgjedhja e dijetarëve dhe nxënësve të dijes që do të marrin pjesë.

**Çështje e rëndësishme që lidhet me organizimin:** është që organizatorët të bëjnë përgatitjet me ata që kanë përvojë, në mënyrë që të kuptojnë se çfarë u nevojitet për seminarin.

Për shembull: zgjedhja e një qyteti për organizimin e një seminarit për herë të parë, qoftë kjo brenda Arabisë Saudite, apo jashta saj. E mirë është që të konsultohen me ata që kanë organizuar seminare dhe mësimet akademike të suksesshme, sepse besimtari konsultohet dhe nuk humb ai që e bën një gjë të tillë.

Disa seminare kanë dështuar për shkak të përvojës së paktë dhe mos konsultimit.



Organizimi i seminareve nuk bëhet në letër, që kur të vijë njerëzit, koha dhe vendi, krijohet një lloj konfuzioni.

E rëndësishme është që organizatorët e seminareve të kujdesen për përfitimin e nxënësve.

Është e ditur se ata që marrin pjesë, janë të përshtatshëm për të mbajtur ligjërata, mirëpo ndoshta nuk është i aftë në mësimdhënie, edhe po të jetë i aftë në mësimdhënie, ndoshta nuk është i aftë në mësimdhënie të këtyre seminareve intensive. Po ashtu, ka prej tyre që nuk janë të aftë në komunikimin me nxënësit gjatë kësaj kohe të shkurtër me diturinë që e përvetëson.

Organizatorët duhet të kujdesen për vendin dhe përgatitjen e tij, të kujdesen për kohën, për zgjedhjen e mësuesit, të lëndëve, të temave dhe librave.

Të gjitha këta kanë nevojë për përpikmëri, e këtë s'mund ta bëjë çdo kush.

Prej të mirave që kanë vëllezërit organizatorë të këtyre mësimëve akademike në xhaminë Shejhul Islam Ibën Tejmije, me në krye vëllaun Fehd el Gurab, Allahu i dhëntë sukses drejt të mirës, po ashtu (prej të mirave) të vëllezërve të tjerë, është se konsultohen me dijetarët për temat, lëndët dhe librat që janë të përshtatshme të zgjidhen.

Dijetarët kanë përvojë se çfarë është e përshtatshme dhe çfarë jo. Ata i dinë këto gjëra prej seminareve të kaluara. Ky libër për shembull, nuk është i përshtatshëm ngase përmbajtja (esenca) nuk është e përqendruar, apo ka metodë të dobët, apo për arsye

se nuk përfshin çdo gjë që nevojitet në këtë dituri, apo të tjera gjëra të ngjashme.

Përgatitja e seminareve me ata që janë të ditur, është diçka e rëndësishme.

## SHTYLLA E DYTË: MËSUESI

Ai është dietari që do të japë mësimet.

Padyshim që dietarët dallojnë në përgatitjen e tyre, sepse Allahu xhel-le ue ala i ka dhuruar njerëzve dhunti. Është e mundur që Allahu t'i japë të movonshmit, atë që i ka ikur të mëhershmit, mund t'i japë të voglit atë që nuk e ka kuptuar i madhi dhe ai që është mesatar në moshë, mund të jetë më pranë rinisë nga aspekti i dhënies së ligjëratave.

Një libër i vogël mund të jepet për një kohë të shkurtër, e po i njejt i libër mund të jepet mësim gjatë një viti, nëse ai jepet mësim çdo javë; ai që e jep mësim mund të ketë sukses. Nëse koha është një javë, ndoshta nuk mund të arrijë të përfundojë atë çfarë mund ta bëjë gjatë një viti. Ai ndoshta shpjegon tre faqe, apo katër dhe lë më shumë se dy të tretat e librit pa shpjegim.

Për këtë arsye, është e mirë që mësuesi ta ndajë librin sipas kohës.

Ajo që ka ndodhur në seminarët e mëparshme në këtë xhami, apo edhe në xhamia të tjera, është se dituria e mësuesit (dietarit) ka qenë më e madhe sesa koha. Ai ka shpjeguar detaje të shumta e të dobishme, mirëpo koha nuk i ka mjaftuar, kështu që i ka lënë nxënësit pa plotësuar shpjegimin e librit.

Në këtë rast, ikën përfitimi për ata që e prezantojnë këtë seminar, e ndoshta ata që e prezantojnë janë me qindra. Kurse ata që përfitojnë nga kasetat, mund të arrijnë mijërat.

Disa thirrësa që kanë vizituar disa vende të Afrikës apo Europës, më kanë treguar se kanë gjetur kasetat e seminareve që janë mbajtur në këtë xhami, apo në të tjera, mirëpo njerëzit përfitojnë nga ai libër që është shpjeguar plotësisht.

Mësuesi duhet të organizojë kohën dhe mos të shkojë pas një dobie të vetme e të ikë koha duke shpjeguar vetëm një apo dy faqe të librit.

Organizatorët e seminarit duhet t'ia venë në dukje këtë gjë dijetarit pas një mësimi apo dy, nëse ai zgjerohet në fillim.

Duhet ruajtur koha dhe duhet kushtuar rëndësia asaj. Shpjegimi duhet të shkojë në përputhje me kohën e shkurtër.

Pra, zgjedhja e mësuesit është e rëndësishme. Ka prej tyre që janë të aftë në mësimdhënie, mirëpo bëjnë përgatitje të madhe. Nganjëherë mësuesi ka nevojë për përgatitje dhe nganjëherë përgatitja bëhet shkak i zgjatjes së lëndës, temës dhe ligjëratës. Mësuesi paraqitet për mbajtjen e mësimit dhe ka shumë njohuri për të dhënë. Ai i jep ato njohuri, mirëpo nxënësi nuk ka nevojë për to në komentimin e këtij libri, sepse me rëndësi është që libri të kuptohet plotësisht. Detajet dhe citimi nga librat, nuk janë të përshtatshme me seminarin intensiv.

Gjatë seminarit, mësuesi duhet t'i kushtojë rëndësi shpjegimit të fjalëve të librit, sqarimit të gjërave që ka për qëllim autori, dhënies së argumenteve për to dhe leximi i shpejtë i librit pa lënë mangësi.

Kjo gjë ka nevojë për përvojë, prezencë të dijes në çdo lëndë dhe pak përgatitje. Mësuesi po ashtu duhet të ndjekë rrugën e

thjeshtësisë kur jep njohuritë dhe dobitë, sepse nxënësit e dijes nuk vazhdojnë nëse nuk marrin dobi akademike.

Prej gjërave që kërkohen tek një mësues është që të jetë i fortë në lëndën akademike, aftësitë e tija të jenë të pranueshme dhe gjuha e tij të jetë e lehtë dhe e qartë. I duhet të jetë larg fjalëve të thella dhe të vështira.

Nxënësit nuk duhet ta ndërpresin mësuesin me pyetje që e prishin inçizimin. Përfitimi i atyre që janë prezentë, arrihet nga shpjegimi i mësimëve dhe mësimi i tyre përmendësh.

Përfitimi i të tjerëve që nuk janë prezentë, arrihet nga dëgjimi i mësimëve të inçizuara në kaseta, sikur shpjegimi i librit të Teuhidit, të imamit të thirrjes, shejh Muhamed ibën AbdulUehhab, Allahu e mëshiroftë. Po ashtu, përfitimi arrihet nga shpjegimi i librit “el Uasitije”, nga Tefsiri i Kuranit të shejhul Islam Ibën Tejmijes, Allahu e mëshiroftë, nga shpjegimi i shejh Muhamed ibën Ibrahimit, Allahu e mëshiroftë, gjithashtu nga shpjegimi i shejhut të nderuar AbdulAziz ibën Baz, Allahu e mëshiroftë, ia lartësoftë gradat në Xhenet dhe e bashkoftë me të sinqertit, po ashtu nga shpjegimet e disa dijetarëve tanë, sikur shejh Ibën Uthejmini, Allahu e mëshiroftë dhe shejh Salih el Feuzan, Allahu e ruajtë. Këto mësimë janë të inçizuara.

Për këta arsye, mësuesi duhet të jetë i vëmendshëm se mësimet e tij janë të ruajtura dhe ndoshta do të përfitohet prej tyre pas një qind vjetësh.

Nëse të gjithë do të jenë të heshtur dhe të përqendruar, atëherë mësuesi do të jetë më i gjallëruar në dhënien e diturisë. Për këtë, Sufjani dhe Maliku, Allahu i mëshiroftë, po ashtu edhe të tjerë

dijetarë veç tyre thonin: “Kur kishim gjallëri, e përcillnim hadithin me zinxhir transmetimi, e nëse nuk kishim gjallëri, e përcillnim hadithin pa zinxhir transmetimi.”

Pra, kjo kthehet tek gjendja shpirtërore e mësuesit, siç kthehet gjithashtu edhe tek gjendja e nxënësit.

Lëvizja e nxënësit, përgatitja e tij, marrja e dijes, heshtja e bukur dhe shënimi që mban në mënyrë të mirë, e gjallërojnë mësuesin që të japë dobitë akademike.

Armët e nxënësit janë lapsi dhe letra.

Me rëndësi është që mësuesi dhe nxënësi të bashkëpunojnë në mënyrë që këto mësimë të inçizuara të dalin me sukses. Këto seminare akademike janë caktuar për nxënësit mesatarë.

Mësuesi duhet të përdorë një metodë në të folur që mos ta largojë të përparuarin (në dije) dhe të jetë e kuptueshme për fillestarin, mirëpo të jetë një metodë e mesme në të folur.

Ky është virtyt i dijetarëve rabanijin (edukues), siç i ka cilësuar Allahu xhel-le ue ala me thënien e Tij:

وَلَكِنْ كُونُوا رَبَّاتَيْنِ بِمَا كُنْتُمْ تُعَلِّمُونَ الْكِتَابَ وَبِمَا كُنْتُمْ تَدْرُسُونَ

**“Mirëpo bëhuni robër edukues, sepse ua keni mësuar Librin të tjerëve dhe e mësoni edhe vetë!”<sup>1</sup>**

Allahu xhel-le ue ala e ka përshkruar dijetarin edukues (rabanij) se është ai që mëson për vete dhe i mëson të tjerët. Kurse ai që

---

<sup>1</sup> Āl Imran: 79.

mëson për vete dhe nuk i mëson të tjerët, ky nuk është prej edukuesve.

Ebu Abdullah el Buhari ka thënë: “Edukues është ai që ua mëson njerëzve dijen e vogël para të madhes”, d.m.th. në varësi të nevojës.

Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem i janë dhënë xheuamiul kelim<sup>2</sup>, e nëse fjalët janë të përmbledhura dhe të dobishme, atëherë ato kuptohen nga masa e gjerë, nga i mençuri, nga teveqeli, nga vendaliu dhe i huaji.

Mësuesi i jep nxënësve të tij të përfitojnë përkufizimet, normat dhe rregullat.

Gjatë seminareve, mësuesi duhet të largohet nga metodat përshkuese dhe me zgjerim në përshkrim, sepse nxënësi dëshiron të mbajë shënim menjëherë rregullat dhe degëzimet, si p.sh. të thotë mësuesi që: rregulli i shirkut të madh është ky dhe rregulli i shirkut të vogël është ky.

Çfarë dallimi ka mes shirkut të vogël dhe atij të fshehtë?

Apo të thotë p.sh: kjo çështje ndahet në katër ndarje, etj.

Këto janë gjërat që mbesin me nxënësin dhe këto i hapin atij portat e diturisë.

Sa i përket metodës përshkuese, këtë e merr nxënësi përmes leximit. Gjërat e dobishme janë dallimet e imëta dhe mësuesi i hap nxënësit horizonte të gjera gjatë seminareve.

---

<sup>2</sup> Me pak fjalë, shpreh domethënie të shumta. (shp)

Kjo është dobia e marrjes së dijes nga dietari. Po të mos ishin dobitë dhe dallimet mes çështjeve të ngjashme, këto mësimë nuk do të kishin ndonjë veçori dalluese, por do të ishin njëlloj sikur marrja e dijes nga librat pa një mësues.

Në disa libra të hershëm në lëndët e Fikhut dhe Akides, do të gjesh se autori parashtron ndarjet me “dhe” apo me “ose”, si p.sh.: uji i pastrues dhe i pastër dhe i piste dhe i dyshimtë. Ose p.sh.: shirku i madh dhe i vogël dhe i fshehtë.

Mësuesi duhet ta thjeshtësojë dhe të thotë: ndarja e parë, ndarja e dytë, ndarja e tretë, e me rradhë.

Apo të thotë: lloji i parë, lloji i dytë, lloji i tretë, e më rradhë.

Kështu bën edhe me çështjet ku ka mospajtim (hilaf); e përmend çështjen dhe përmend mendimet lidhur me të në formë të rradhitur, si p.sh. të thotë: mendimi i parë, argumenti i tij dhe mënyra e argumentimit. Pastaj përmend mendimin e dytë, e kështu me rradhë. Më pas e përmend mendimin më të saktë që i duket atij, e mund të mos jetë mendimi më i saktë tek të tjerët.

Gjithashtu prej gjërave me rëndësi është që nxënësi mos ta shikojë mësuesin e seminareve se është imam në çdo gjë, edhe po të jetë profesor në fakultet apo diku tjetër. Sepse do të largohet prej mësuesit nëse gjen tek ai mangësi, dhe atëherë nuk do të përfitojë nga askush, përveç nga njerëz që Dhehebiu i ka përshkruar me thënien e tij: “Thuajse i kam parë vetëm në libra, apo të mbuluar nga dhëu<sup>3</sup>.”

---

<sup>3</sup> Sepse kanë vdekur dhe nuk janë gjallë. (shp)



Mos i vendos mësuesit kusht të vështirë, sepse e humb këtë dhe pastaj atë tjetrin. Rëndësi ka që mësuesi ta japë diturinë dhe i frikësohet Allahut të Lartësuar në këtë gjë; nuk i përkatëson Allahut xhel-le ue ala, as Pejgamberit të Tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, as fesë Islame dhe as diturisë fetare gjëra që nuk i di nga fjalët e dijetarëve. Nuk fut mendimet e veta (ixhtihadin e tij) në dituri, sepse qëllimi i mësimeve akademike është përcjellja e dijes siç e kanë përcjellë dijetarët.

Dituria në këtë umet është: ka thënë Allahu, ka thënë Pejgamberi i Tij, kanë thënë sahabët dhe kanë thënë dijetarët.

Mos vendos kushte të vështira për mësuesin, që mos të kesh mendim të keq për të dhe pastaj të privohesh nga përfitimi prej tij. Mos kushtëzo që ai mos të rrëshqasë në ndonjë çështje, apo mos të gabojë në ndonjë çështje, sidomos kur ka seminare akademike.

Mund të gjesh një dobi tek nxënësi që nuk është tek mësuesi, dhe mësuesi përfiton prej nxënësit të tij.

Ibën Hashab el Hanbeli thoshte: “Unë jam nxënës i nxënësve të mi.” Kjo është e saktë, sepse mësuesi përfiton dhe nxënësi përfiton.

Mësuesi i sapa diplomuar, i cili jep mësim në Ministrinë e Edukimit, në shkollë të mesme, apo në gjimnaz, apo në fakultet, kur fillon mësimdhënien përfiton shumë nga nxënësit. Me kalimin e kohës, përfiton më pak nga ata dhe më shumë përfitojnë të tjerët sesa ai nga ata, sepse para tij ka intelekto që diskutojnë me të për fjalët që i thotë, andaj mësuesi është i përqëndruar dhe i përgatitur. Mirëpo, mund të paraqitet një çështje dhe mendimi që

e di dietari mund të jetë jo i saktë, apo nuk është mendimi i verifikuar. Diçka mund t'i ikë mësuesit, apo mund të gabojë në përkatësimin e një hadithi apo diçka e ngjashme dhe nxënësi mund të dije të saktën në këtë çështje...

Pra, dituria përfitohet mes mësuesit dhe nxënësit gjatë seminareve, andaj mësuesi nuk duhet ta përbuzë marrjen e dobisë nga nxënësi, po ashtu nxënësi nuk duhet të ketë turp dhe mos t'ia japë dobinë mësuesit, mirëpo nxënësi duhet që me edukatë dhe me turp ta diskutojë me mësuesin e tij në formë pyetjeje.

Pra, nxënësi nuk duhet të caktojë dhe vendosë kushte të vështira, të cilat mund të gjenden vetëm tek imamët e famshëm si Ahmed ibën Hanbeli, Buhariu, Ibën Tejmije etj.

## SHTYLLA E TRETË: NXËNËSI

Ky është nxënësi i dijes që merr pjesë në seminare. Ai ka cilësi, virtyte dhe sjellje.

### **Këshilla për nxënësin e diturisë:**

#### **Këshilla e parë:**

**Përkushtimi (el Ikhlas):** e kjo duke patur shpresë të sinqertë tek Zoti i tij Bujar, dhe duke ia hapur zemrën diturisë dhe përfitimit. Zemrës i shfaqen angazhimet dhe mendimet. Gjatë kohës që nxënësi është i heshtur, atij i vjen një mendim që ia ndërpret përfitimin. Ai dëshiron ta mledhë veten, mirëpo e ka të vështirë, andaj i përzihen dobitë dhe ky mendim anulon dobinë.

Patjetër duhet të drejtohem nga Allahu xhel-le ue ala dhe ta lusim që të na japë diturinë në Fe, përfitimin dhe durimin në kërkimin e dijes, sepse dituria ka nevojë patjetër për durim. Kjo ka nevojë për përkushtim dhe sinqeritet ndaj Allahut xhel-le ua ala' dhe drejtim nga Ai, sepse kërkimi i diturisë është adhurim.

**“Me të vërtetë melekët i shtrijnë krahët e tyre për nxënësin e diturisë, ngase janë të kënaqur me atë që bën. Me të vërtetë për dietarin kërkojnë falje çfarë ka në qiell dhe në Tokë; edhe peshqit që janë në ujë”.<sup>4</sup>**

---

<sup>4</sup> Pjesë nga hadithi i transmetuar nga Ebu Daudi 3641, Tirmidhiu 2683 dhe Ibën Maxheh 223 nga Ebud-Derda' radijAllahu anhu.

Ky është virtyt i madh, andaj ki mendim të mirë për Allahun xhel-le ue ala – o kërkues i diturisë – dhe drejtohu nga Ai, që Allahu xhel-le ue ala ta hapë zemrën tënde për diturinë dhe ta skalisë atë në zemër.

## **Këshilla e dytë:**

### **Përgatitja e mjeteve, si lapsi dhe fletët.**

Lapsin e bën gati para mësimit. Këtë çështje e kanë theksuar Khatibi në librin 'Xhamiul xhamia' dhe Ibën AbdulBerr në librin 'el Xhamiu li bejanil ilmi ue fadlihi', e të tjerë dijetarë. Është neglizhencë dhe pakujdesi që nxënësi të prezantojë dhe ka harruar lapsin, apo t'i ketë mbaruar boja.

Sa i përket fletëve, nxënësi duhet të përgatisë për çdo lëndë një apo më shumë fletore, të sistemuara dhe të rradhitura. Gjitha këto sjellin renditje (rregull) të mendjes.

Nëse nxënësi nuk është i kthjellët në mendime, atëherë pakujdesia do të vërehet tek dituria dhe fletoret e tij.

Ai nuk duhet të shkruajë shumë lëndë në një fletore, gjithashtu duhet të largohet nga shkrimi përreth librit, sepse libri do të rëndohet e më pas nuk do të dijë të orientohet në të.

**Imam Ahmedi është pyetur rreth të shkruarit me shkrim të vogël, dhe ai ka thënë: "E urrej këtë gjë, sepse nuk i dihet se kur ka nevojë nxënësi për atë dobi. Atij ndoshta i duhet ajo dobi, mirëpo nuk është në gjëndje ta nxjerrë atë." Kjo gjë është e saktë.**

Shkrimet përreth librit bëhen pa një renditje, bëhet të ngjeshura me shkrimin e shtypur, e ndoshta shkrimi nuk është i qartë.

Lavdi Allahut, sot fletët nuk mungojnë, dhe gjithashtu janë të lira.

## **Sa i përket shkrimit në fletore, kjo gjë kërkon një lloj rregulli:**

Librit që e studion t'i vendosë numra nga njëshi e me radhë. Për çdo çështje që mësuesi jep një dobi, e shkruan në një fletë të veçuar, më pas, dobinë tjetër e shkruan në fletën pasardhëse. Ta bëjë këtë gjë edhe nëse dobia (e dhënë nga mësuesi) është një rresht, e mos të thotë me vete se fleta ngelet bosh; sepse një ditë mund t'i duhet (ajo hapsirë boshe), ditën kur të dëshirojë të zgjerohet në atë çështje dhe dijetari nuk është zgjeruar. E shkruan origjinën e çështjes, e më pas shton njohuritë e tija.

Këto shpjegime do të jenë themeli i një komentimi të madh për nxënësin, në të ardhmen, në dashtë Allahu i Lartësuar!

### **Këshilla e tretë:**

**Nxënësi që nuk ka mundësi të prezantojë të gjitha mësimet, mirëpo dëshiron të zgjedhë (mësimet) në varësi të kohës që ka, atëherë ai duhet të zgjedhë lëndët që i nevojiten për Fenë e tij, në mënyrë që të plotësojë aftësitë e tija akademike.**

P.sh. nëse nxënësi nuk e ka studiuar Teuhidin, ose e ka studiuar për njëfarë kohe dhe dëshiron ta përsërisë. Lënda e Teuhidit do të jetë themelore në zgjedhjen e tij (për studim), ndërsa kohën që i ka mbetur, ia kushton temave dhe diturive të tjera. Pra, nxënësi duhet të zgjedhë kohën dhe lëndën e përshtatshme për të.

## **Këshilla e katërt:**

### **Përgatitja e mirë e mësimit.**

Si mundet që nxënësi t'i përgatisë mësime, kur ato janë të një pas njëshme?!

- Kjo bëhet duke mësuar përmendësh tekstin përpara se të dëgjojë komentimin e dijetarit, kështu nxënësi arrin një formim akademik të saktë.
- Po ashtu përgatitja bëhet duke shikuar çështjet që i nevojiten atij, kjo duke e lexuar tekstin dhe duke vënë shenja tek çështjet e pakuptueshme. Kështu përgatitet që t'i kuptojë ato nga mësuesi. Nuk është kusht që përgatitja e nxënësit të jetë sikur ajo e mësuesit.
- Me këtë përgatitje nuk është për qëllim vetëm mësimi, por gjithashtu është për qëllim krahasimi i aftësisë së nxënësit me atë çfarë i jep mësuesi.

Me këtë metodë, aftësitë akedemike të nxënësit rriten me kalimin e kohës.

Nxënësi përgatitet dhe e shikon mënyrën sesi mësuesi e trajton librin dhe gjithashtu si e trajton ai vetë.

P.sh. libri 'Bulugul meram' tek tema e namazit, nxënësi e ka përgatitur hadithin duke u rikthyer tek librat 'Subulus-selam' dhe 'Fet'hul Bari' apo të tjerë. Nxënësi shikon se çfarë ka përfituar (nga leximi i tij) dhe më pas bën krahasimin sesi e ka trajtuar hadithin dijetari. Pa dyshim që nxënësi do të arrijë dobi që nuk i ka ditur.



Po ashtu mësuesi duhet të zgjedhë nga mesitë e nxënësve të tij atë që di të japë mësim, e ta shtojë kujdesin ndaj tij, t'ia sqarojë sesi jepet mësimi dhe si t'i rradhisë çështjet.

Një nxënës mund të paraqitet tek mësuesi dhe t'i thotë: unë kam prezantuar në seminarin e vitit të kaluar dhe kam dëgjuar shpjegimin që i ke bërë librit 'Bulugul meram' apo 'el Erba'ij en-Neueuejjeh'... mirëpo mësuesi mund të harrojë, për shkak të nxënësve të shumtë, e ndoshta kujtohet. Mirëpo, mësuesi nuk e harron nxënësin e zellshëm, sepse krijon një mendim të mirë për mënyrën e bukur sesi nxënësi e ka trajtuar tekstin e librit, kuptimin e hadithit dhe edukatën karshi vetë mësuesit.

## **Këshilla e pestë:**

### **Shkrimi i dobive që jepen nga mësuesi.**

Nxënësi nuk duhet të referohet vetëm tek dobitë që ka marrë nga seminarët e mëparshme. Ai nuk duhet të thotë: nuk kam nevojë që të shkruaj, sepse mesimi inçizohet.

Ky është gabim i madh në të cilin bien disa nxënësia. Shkrimi nga ana e nxënësit në prezencë të dijetarit, ka ndikim në përgatitjen e tij dhe sjelljen akedamike që duhet. Dituria ka mund dhe përpjekje.

Me anë të shkrimit, krijohet një aftësi në përmbledhjen e diturisë, sepse nxënësi nuk është në gjendje të shkruajë çfarë thotë mësuesi gjë për gjë. Për këtë arsye, duhet të bëjmë dallim mes asaj që nxënësi e përcjell me diktim dhe asaj që e përcjellë nga dëgjimi i tij. Ka mundësi që përmbledhja e bërë nga nxënësi të ketë shumë mangësi nga ajo që ka thënë mësuesi.

Pra, çfarë kihet për qëllim me shkrimin?

Kihet për qëllim kalitja e nxënësit në aftësinë e përmbledhjes. Në fillim dëgjon dhe pastaj përmbledh. Nxënësi vëren se dijetari në fillim flet shpejt dhe nuk ka mundur ta ndjekë me shkrim. Herën e dytë ka të mundur të shkruajë, mirëpo disa gjëra i kanë ikur. Në këtë mënyrë vjen koha që nxënësi të shkruan me përmbledhje shembullore, sepse tek ai është formuar një aftësi e tillë. Kjo arrihet me stërvitje.

**E si bëhet stërvitja?** Ajo bëhet me çfarë përmendëm më lart dhe duke mos u mbështetur tek inçizimi.

## **Këshilla e gjashtë:**

### **Mëshira mes nxënësve.**

Mundet që pjesëmarrësit e këtyre seminareve të kenë nivele të ndryshme:

- 1- Ka prej tyre që prezantojnë për dijen.
- 2- Ka prej tyre që janë fillestarë.
- 3- Ka prej tyre që prezantojnë sepse është tubim diturie dhe dëgjon (sidomos nëse mësimi është pas namazit të sabahut, apo në kohë kur përgjigjen duatë).
- 4- Dhe ka prej atyre që prezantojnë thjeshtë për dobi dhe mjaftohen me çfarëdo dobie që e arrijnë.

Faktikisht nxënësit duhet të kujdesen për njëri-tjetrin. Nxënësi duhet t'i mësojë metodën vëllaut të tij fillestar, po ashtu duhet ta këshillojë atë.

Për këtë arsye, ne duhet ta mëshirojmë njëri-tjetrin gjatë mësimëve akademike dhe në çdo gjë që lidhet me diturinë.

Nganjëherë dijetarët i kanë filluar librat e tyre duke e porositur nxënësin që të jetë i mëshirshëm. Do të shikoni se gjatë ixhazeteve të hadithit, hadithi i parë që përcjellin është:

**“Të mëshirshmit i mëshiron Mëshiruesi. Mëshironi ata që janë në Tokë dhe do t’ju mëshirojë Ai që është në qiell.”<sup>5</sup>**

---

<sup>5</sup> Transmeton Ahmedi në Musnedin e tij, me numër 6494 (11:33), Tirmidhiu me nr. 1924, Hakimi në “el Mustedrak” (4:159) nga hadithi i Abdullah ibën Amër ibnul Ās, radijAllahu anhumë.

Ky hadith njihet tek dijetarët si hadithi “i parë i përcjellë”, sepse secili dijetar thotë për dijetarin e evet: më ka thënë dijetari im filani dhe ky është hadithi i parë që kam dëgjuar prej tij.

Ka thënë: më ka thënë dijetari im filani dhe ky është hadithi i parë që kam dëgjuar prej tij.

Kështu, derisa të arrihet tek brezi i pasuesve të tabi’inëve; të gjithë për herë të parë.

**Pyetje:** pse e mësojnë hadithin: **“Të mëshirshmit i mëshiron Mëshiruesi...”?**

**Përgjigja:** dije – Allahu të mëshiroftë – se prej virtyteve të nxënësit të dijes, me të cilën Allahu azze ue xhel-le e begaton dhe e mëshiron atë, është që të jetë i mëshirshëm me ata që janë përreth tij; i orienton, i mëson, i ndihmon etj.

Nëse gjatë kërkimit tënd të diturisë je i mëshirshëm ndaj njerëzve, ndaj shokëve, ndaj miqve dhe atyre që janë prezentë duke bashkëpunuar me ta në mirësi, atëherë përgëzohu me mëshirë nga Allahut xhel-le ue ala, përgëzohu me premtimin e Pejgamberit të Tij alejhis-salatu ues-selam: **“Të mëshirshmit i mëshiron Mëshiruesi.”**

## MBYLLJA

E lus Allahu xhel-le ue ala që t’ju bëjë të begatë dhe të dobishëm. Domethënia e të “bërit juve të begatë”, siç thotë Allahu i Lartësuar në suren Merjem<sup>6</sup> duke treguar për Isai alejhis-selam:

**“E më bëj të begatë kudo që të jem..”,** e kjo duke qenë mësues i diturisë.

Dijetarët kanë thënë në komentimin e këtij ajeti: **“I begati prej robërve të Allahut, është ai që i mëson njerëzve të mirën.”**

Andaj, e lus Allahu që t’ju bëjë të begatë, të dobishëm, që këto mësimet akademike t’i bëjë të dobishme për atë që i jep dhe për ata që i marrin. E lus Allahun që t’i begatojë të gjithë, t’ju frymëzojë udhëzimin, të saktën, të na japë ne dhe ju kuptimin në Fe, ndjekjen e Sunetit dhe mos të na lërë në dorën tonë as sa bën syri të hapet e të mbyllet.

Me të vërtetë Ai është Dhurues dhe Bujar. O Allah na fal të gjithë ne.

Salavatet, selamet dhe begatit qofshin mbi Pejgamberin tonë Muhamed.

---

<sup>6</sup> Ajeti 31.

# **SHTESË**

## **Pyetje-përgjigjet**

**Një pyetës thotë:**

Ne jemi larg këtij seminari dhe nuk kemi nxënës diturie, mirëpo mund të sigurojmë kasetat e seminarit. Sa mund të përfitojmë prej tyre?

Sikur ka për qëllim: a mund të përgatitet me to dhe të japë mësim atje ku është.

**Përgjigjja:**

Nuk ka problem nëse i mëson të tjerët. Nuk është kusht që të jesh dijetar i thelluar për të dhënë mësim, apo të jesh mësues në fakultet, apo i specializuar në një lëndë.

Mirëpo duhet t'i frikësohesh Allahut xhel-le ue ala për atë çfarë thua, dhe dije se do të merresh në llogari për atë çfarë thua.

Mos ia përkatëso një dijetari një fjalë që nuk e ka thënë, sa për të dalë nga situata.

Mos thuaj për Allahun çfarë nuk ke dituri. Fol atë që je i sigurtë, me argument të qartë prej gjërave që i ke mësuar nga kasetat apo nga të tjerat, pa shtuar gjë.

Nuk është me rëndësi që të mbash ligjëratë për gjysmë ore, mirëpo majftojnë dhjetë minuta. Me rëndësi është që të shpërblehesh për të nga Allahu xhel-le ue ala me të mirat të shumta, në dashtë Allahu.

Kam vënë re disa që kanë patur dëshirë në mësimin e njerëzve në xhamia, se nuk kanë patur vazhdimësi; sepse kanë gabuar duke u zgjeruar në çështje të pasigurta, me gjëra që në realitet nuk i kanë ditur. Ata janë zënë ngusht me fjalë, apo janë zgjeruar duke folur dhe kanë hyrë në çështje dhe mendime të tyre personale, ndërkohë që dituria është e kundërta e asaj që kanë thënë dhe fjalët e tyre ishin gabim.

Mbase i kanë përkatësuar dijetarëve fjalëve që nuk i kanë thënë, si thënia: e kam dëgjuar këtë gjë nga filan dijetar, ndërkohë që dijetari është larg asaj.

Si rrjedhojë, njerëzit largohen nga ai.

Pra, mësimdhënia e saktë nga ai që ka studiuar drejtpërdrejtë, që ka prezantuar këto seminare, pastaj ka udhëtuar për në vend të vet dhe ka mësuar të tjerët; Allahu xhel-le ue ala ia shpërbleftë me të mira. E lus Allahun t'ia shkruajë këto gjurmë, ta bëjë prej nxënësve të dijes, t'ia rrënjosë diturinë në gjoks dhe ta bëjë të dobishëm për ata njerëz që dëshiron Allahu.

**Si përfundim:** nuk ka problem që të dëgjojë nga kasetat dhe të përcjellë atë që e ka kuptuar, duke qenë i sigurtë, në formë të përmbledhur, pa zgjatje dhe pa gënjyer ndaj Allahut, ndaj Pejgamberit sal-Allahue alejhi ue sel-lem dhe ndaj dijetarëve.

Përcill atë që e ke mësuar dhe e ke dëgjuar nga dijetarët, apo atë që e ke lexuar me siguri, apo që e ke kuptuar pa pështjellime dhe paqartësi. Mos përcill diçka që e ke nxjerrë nga përfundimi yt, sepse kështu Allahu xhel-le ue ala do të bëjë të begatë.



Ndoshta në disa fshatra dëgjon nga disa dijetarë tek shpjegojnë një libër me pak fjalë, mirëpo janë fjalë të sakta dhe kanë begati, sepse nuk janë gabim.

Përcillja diturinë familjes tëndë, fëmijëve tuaj, shokëve tuaj dhe atyre që kanë nevojë, duke qenë i sigurtë për atë që e përcjell. Frikësohu marrjes në llogari para Allahut xhel-le ue ala, sepse Allahu subhanehu ue teala do ta marrë në llogari dijetarin, nëse ai gënjen në diturinë e tij, sepse po gënjen ndaj fesë dhe të gënjyerit ndaj fesë ka efekte të këqia. Ti tillët janë dijetarët e këqinj, Allahu i Lartësuar na ruajtë.

~ 2 ~

**Një pyetës thotë:**

Si ta luftoj tkurrjen dhe dobësimin e vullnetit në kërkimin e dijes?

**Përgjigjja:**

Fillimisht tkurrjen e lufton duke iu kthyer Allahut xhel-le ue ala, pastaj lexon dhe dëgjon për vlerën e dijes dhe dijetarëve, për pozitë e dijetarëve dhe shpërblimin e tyre, për shpërblimin e madh që kanë nxënësit e dijes, për moralin e nxënësve të dijes, për moralin e thirrësve, për vlerën e thirrjes, për vlerën e përcjelles së mirës dhe udhëzimit.

I lexon ajetet që kanë ardhur për këto që thamë, madje lexon edhe komentimin e dijetarëve për to dhe hadithet lidhur me to.

Allahu azze ue xhel-le do të dhurojë dëshirë të madhe për kërkimin e dijes.

### **Një pyetës thotë:**

E kam kërkuar dijen vite me rradhë, megjithatë njohuritë nuk më nguliten dhe nuk ndjej të kem përfituar. Me çfarë më këshilloni? Allahu ju shpërbleftë me të mira!

### **Përgjigjja:**

Mos thuaj se nuk ndjej të kem përfituar, sepse nxënësi i dijes është në adhurim.

Qëllimi i kërkimit të dijes është kënaqësia e Allahut xhel-le ue ala ndaj robit të Tij.

E dini për burrin që u kthye i penduar dhe **“i erdhi Meleku i Vdekjes. Ranë në mospajtim Melekët e Mëshirës dhe Melekët e Dënimit** (se cili prej tyre do ta merrte). **Melekët e Mëshirës thanë: “Erdh i penduar, me zemër të kthyer nga Allahu i Lartësuar!”**, ndërsa **Melekët e Dënimit thanë: “Nuk ka bërë kurrë ndonjë të mirë!”**

**Atyre i erdhi një melek me paraqitjen e njeriut dhe e morën për gjykatës mes tyre. Ai tha: “Matni mes dy vendeve dhe vendit që është më afër, i takon ta marrë.” E matën dhe ishte më afër vendit që ishte nisur, andaj e morën Melekët e Mëshirës.”<sup>7</sup>**

---

<sup>7</sup> Shikoje hadithin e plotë tek Sahihu i Buhariut 6/373 dhe Sahihu i Muslimit me nr. 7008 nga hadithi i Ebu Seid el Hudriut radijAllahu anhu.

Këtij burri të penduar iu fal, sepse lëvizja e tij iu llogarit në favor. Andaj, lëvizja e nxënësit të dijes për diturinë, është adhurim, sikur lëvizja e burrit të penduar që u zhvendos për tek vendi i mirë.

Kërkimi i dijes është më i mirë për ty sesa namazet vullnetare, apo sesa disa adhurime vullnetare. Patjetër duhet të kihet qëllim të sinqertë.. pastaj përfitimi vjen gradualisht. Nuk është për qëllim që ose të jesh dijetar, ose mos ta kërkosh fare diturinë.

Qëllimi nga kërkimi yt i dijes është heqja e injorancës nga vetja, ta adhurosh Allahun xhel-le ue ala me adhurime të sakta, të kesh një besim të saktë, të kthehesh nga Allahu xhel-le ue ala duke qenë i pastër nga dyshimet dhe i pastër nga dashuria për famë.

Allahu xhel-le ue ala ka thënë:

يَوْمَ لَا يَنْفَعُ مَالٌ وَلَا بَنُونَ (88) إِلَّا مَنْ أَتَى اللَّهَ بِقَلْبٍ سَلِيمٍ

**“Ditën kur nuk bën dobi as pasuria dhe as fëmija, përveç atij që del para Allahut me zemër të pastër.”<sup>8</sup>**

Allahu xhel-le ue ala po ashtu ka thënë:

إِنَّ الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ إِنَّا لَا نُضِيعُ أَجْرَ مَنْ أَحْسَنَ عَمَلًا

**“Sa për ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, sigurisht që Ne nuk do t’ua humbim shpërblimin punëmirëve.”<sup>9</sup>** Nëse je i dobishëm vetëm për veten dhe familjen, kjo do të ishte mirësi e madhe.

---

<sup>8</sup> Esh-Shuara’ 88-89.

<sup>9</sup> El Kehf: 30.

**Një pyetës thotë:**

Nuk mund të jem një dijetar edukues, sepse kam zgjuarsi të madhe, apo arsyetime të tjera, andaj çfarë më këshilloni?

**Përgjigjja:**

Të këshilloj me atë që këshillova vëllaun tënd përpara.

Nuk është kusht i kërkimit të dijes që të bëhesh dijetar edukues. Kërkoji Zotit tënd që të japë sukses.

Ti nuk e di, nëse del dhe jep mësim e bëhesh dijetar i njohur, nuk e di nëse lirohesh nga obligimi apo jo?

Nuk e di nëse është e mirë për ty apo sprovë?

Qëllimi yt nga kërkimi i dijes është:

1. Të synosh heqjen e injorancës tënde.
2. Allahu xhel-le ue ala të kënaqet me ty ngase ke ndjekur një rrugë në të cilën kërkohet dituria.
3. Të synosh ndreqjen e zemrës dhe gjymtyrëve tuaja.

Kërkoje dijen! Nëse Allahu xhel-le ue ala të bën prej dijetarëve edukues, atëherë kjo është mirësi dhe begati nga Ai. Këtë gjë e di Zoti i krijesave, përndryshe ti je nxënës dije.

Allahu xhel-le ue ala ka thënë:

وَرَبُّكَ يَخْلُقُ مَا يَشَاءُ وَيَخْتَارُ ۗ مَا كَانَ لَهُمُ الْخِيَرَةُ ۗ سُبْحَانَ اللَّهِ وَتَعَالَى عَمَّا

يُشْرِكُونَ

**“Zoti yt krijon ç’të dojë dhe zgjedh, ndërsa ata (idhujt) nuk mund të zgjedhin. Qoftë i lavdëruar Allahu dhe i lartësuar mbi gjithçka që ia shoqërojnë Atij (në adhurim)!”<sup>10</sup>**

E lus Allahun azze ue xhel-le që të japë ty dhe gjithë vëllezërve tuaj sukses, po ashtu t’ia japë atyre që synojnë të mirën, mirëpo nuk ia arrijnë.

Esh-Shenkiti ka thënë: **“Mos ki mendim të keq për dijen o djalosh, sepse mendimi i keq për dijen është shkatërrim.”**

---

<sup>10</sup> El Kasas: 68.

### **Një pyetës thotë:**

Çfarë orientimi keni për ata që marrin pjesë dhe në vendet e tyre ka shumë bidate dhe shirk?

### **Përgjigjja:**

Përhapja e diturisë është adhurim dhe xhihad.

Allahu xhel-le ue ala e ka urdhëruar Pejgamberin e Tij, kur ai ishte në Mekë, që t'i luftonte idhujtarët me dituri. Allahu i Lartësuar ka thënë:

فَلَا تُطِعِ الْكَافِرِينَ وَجَاهِدْهُمْ بِهِ جِهَادًا كَبِيرًا

**“Mos i dëgjo mohuesit, por luftoju ata me forcë nëpërmjet këtij (Kurani).”<sup>11</sup>** D.m.th. me dituri dhe me Kuran.

Xhihadi më i madh që mund të jetë kundër armiqve është nëpërmjet diturisë, ku përmes tij vazhdon e mira dhe ndikimi. Nxënësi i dijes është ndikues, e përhap të mirën dhe me kalimin e kohës ajo zgjerohet.

Në hadith thuhet: **“Vlera e dijetarit ndaj adhuruesit është sikur vlera ime me më të voglin (në vlerë) mes jush.”<sup>12</sup>**

Ai që është i mirë vetëm për veten, ai ndikon vetëm tek vetja.

---

<sup>11</sup> El Furkan: 52.

<sup>12</sup> Transmeton Tirmidhiu me nr. 2686 dhe ka thënë: hadith hasen. Hadithi përcillet nga Ebu Umameh radijAllahu anhu.

Pa dyshim se vlera e dijes është e madhe. Nëse nxënësit të dijes i jepet mundësia që të japë mësim në vendin e tij, atëherë kjo është diçka e mirë. Nëse i jepet mundësia të zhvendoset dhe të mësojë ata që kanë nevojë, edhe kjo është diçka e mirë.

Zakonisht njerëzit shkojnë tek dijetarët e njohur dhe largohen nga nxënësit e dijes që janë nën gradën e tyre.

Them: kjo gjë është e natyrshme.

Roli i nxënësve të dijes që kanë prezantuar [shpjegimin] e disa librave të vegjël, dhe kanë aftësi në lëndën e Teuhidit, apo Sirës, është se që të zhvendosen në një vend tjetër dhe të bëjnë një seminar akademik në Afrikë, apo Indonezi. Të japin pasuri [për t'i organizuar] dhe dituri në Akide, duke iu frikësuar Allahut xhel-le ue ala për atë çfarë thonë.

Dituria më madhështore për një vend ku ka shumë bidate dhe shirk, është dituria me të cilën kanë ardhur pejgamberët alejhimus-salatu ues-selam dhe kanë thirrur për tek ajo, e cila është dituria e Teuhidit të Allahut xhel-le ue ala dhe që është obligimi i njërëzve ndaj Allahut.

Kjo është gjëja më madhështore që mund të japësh në trashigimi dhe ta lësh në një vend.

Pastaj i mëson Fjalën e Allahut xhel-le ue ala dhe Sunetin, sepse këto janë çfarë mbesin dhe pranohen. I mosën dyzet hadithet dhe të ngjashme.

Mos ia vër veshin kritikave të dijetarëve të atij vendi dhe kundërshtimeve të tyre, sepse ata frymëzohen nga pëshpëritjet e



Shejtanit dhe armiqësimit të Shejtanit ndaj njerëzve të devotshëm të Allahut. Për këtë arsye, gjëja më madhështore me të cilën luftohen armiqtë e Allahut xhel-le ue ala dhe Shejtani është përhapja e diturisë, andaj përhape dijen në çdo vend, sipas mundësisë që ke dhe frikësohu Allahut xhel-le ue ala lidhur me këtë gjë.

وَقُلْ رَبِّ زِدْنِي عِلْمًا

**“Dhe thuaj: Zoti im, ma shto dijen!”<sup>13</sup>**

---

<sup>13</sup> ТаHa: 114.

**Një pyetës thotë:**

Çfarë pjese kanë njerëzit e specializimeve shkencore, sikur inxhinieria, kimia etj, nga këto mësimet dhe seminare? Ata janë të shumtë dhe dëshirojnë dobinë.

**Përgjigjja:**

Është detyrë për çdo musliman që të mësojë atë çfarë ia saktëson besimin dhe adhurimin.

Kjo është detyrë për inxhinierin, mjekun, të specializuarin në matematikë, kimi, arkitekturë, informatikë dhe dituri të tjera.

Të tillët mësojnë atë çfarë ia saktëson besimin dhe adhurimin e tyre. Këto seminare janë mundësi për ta, që të përfitojnë shumë dituri, në një kohë të shkurtër.

Nëse diplomohen dhe punosohen, atëherë marrin nga çdo dije atë që i nevojitet.

Pa dyshim se ata kanë përgatitje të lindur në kuptimin e dijeve fetare, andaj kanë thënë disa të mençur: **“Kush nuk është inxhinier, mos të hyjë në shtëpinë time.”** Këtë ia ka thënë disa njerëzve, sepse njerëzit e kësaj diturie, janë mendjehollë dhe të përshtatshëm për dijet fetare.

Dy dituri, ajo e inxhinierisë dhe ajo e mjekësisë, janë më të afërtat me dituritë fetare.

Për këtë arsye, Shafiu, Allahu e mëshiroftë, ka thënë: **“Kam vështruar dituritë dhe më të mirat janë dy: dituria e fesë dhe dituria e trupit. Kam medituuar dhe dituria e trupit është mjekësia shpëtuese në këtë dynja, ngase shëron sëmundjet që ka trupi.**

**Po ashtu dituria e fesë rregullon trupin dhe shpirtin në dynja dhe në Botën Tjetër. Për këtë, i kam dhënë përparësi dijes së fesë ndaj asaj të trupit.”**

Shafiu, Allahu e mëshiroftë, ka patur orientim nga mjekësia. Ai posedonte dijen e mjekësisë dhe atë të intuitës. Edhe vdekja e tij ka qenë për shkak se merrte disa barna natyrale për forcimin e kujtesës (mësimi përmendësh).

Shafiu lindi vitin 150 h dhe vdiq në vitin 204. D.m.th. ka jetuar pesëdhjetë e katër vite, duke mos jetuar gjatë.

Shkaku i vdekjes së tij është konsumi i disa barnave – sepse ishte i aftë në mjekësi – dhe ato ndikuan në gjakun e tij, andaj e goditi një hemorragji, d.m.th. vdiq nga një hemorragji e brëndshme.

Imam Ibën Kajim, Allahu e mëshiroftë, merrej me mjekësi dhe astronomi. Në librin e tij “Miftahu daris-seadeh” ka treguar gjithë anatonime e trupit të njeriut. Ka përmendur mëlçinë, përshkrimin dhe anatonimë e saj. Ka përmendur shtresat e lëkurës.

Mirëpo dijetarit nuk i takon t’i parashtrojë këto gjëra.

Ai ka përmendur një përshkrim të eklipsit të Hënës dhe të Diellit. Po ashtu me një mënyrë matematikore dhe inxhinierike, bazuar mbi format konike, duke llogaritur vendin, këndin dhe kohën, që

po ta praktikosh, do të jesh në gjendje të llogarisësh kohën e eklipsit të Diellit dhe të Hënës.

Pra, dijetarët edukues, të cilët janë dijetarët e umetit, janë angazhuar me disa dituri, sepse ato sjellin mendjeprehtësi.

Ai që është mjek, apo inxhinier apo i ngjashëm me ta, nëse i jepet sukses të mësojë dituritë fetare, atëherë ai është prej njerëzve me zell të madh.

### **Vendimet vijnë në varësi të njerëzve me zell, dhe vlerat vijnë në varësi të njerëzve me vlerë.<sup>14</sup>**

Prej çudive të Shafiut, Allahu e mëshiroftë, është se merrej me dijen e intuitës.

Intuita – siç dihet – është tre llojesh:

1. Intuitë e besimit.
2. Intuitë e stërvitur.
3. Intuitë e natyrshme

I mësoni në Akide.<sup>15</sup>

Kemi për qëllim intuitën e natyrshme, që argumentimi vjen nga paraqitja, si p.sh. forma e fytyrës për disa cilësi që fshihen.

P.sh. thotë: ky i ka sytë të mprehtë, që tregojnë zgjuarsitë të madhe.

Ky i ka sytë e mekur, që tregojnë budallallëk.

---

<sup>14</sup> E thënë nga el Mutenebbi kur pat lëvduar Sejfuddeulen.

<sup>15</sup> Shiko librin “Sherhul Akideti et-Tahavijeh” 753.

Ecja e këtij tjetrit tregon se është i ngutur në punët e tij.

Forma e ballit të këtij tjetrit tregon për këtë gjë.

Këtë e thoshte nga intuïta, pa u shoqëruar me ta.

Kjo dituri është prezente tek njerëzit me kohë; ka prej saj që është e saktë dhe ka që është gabim.

Shafiu, Allahu e mëshiroftë, është marrë me këtë dituri.

**Ka thënë: “U nisa për në Jemen, në kërkim të librave të intuïtës. Arrita t’i shkruaj dhe t’i mbledh. Kur erdhi koha e kthimit, rrugës kalova pranë një burri i cili ishte i ulur në oborrin e shtëpisë së tij. Sytë i kishte blu, ballin e lartë dhe qose. I thashë: “A ka ndonjë shtëpi?!” Tha: “Po!”**

**(Imam Shafiu thotë): kjo fizionomi është ndër më të këqijat sipas intuïtës. Ai më priti dhe pashë se ishte shumë bujar. Më nisi darkë, parfum, sanë për kafshën time, dyshek dhe mbulesë. Natën nisa të sillesha duke menduar çfarë të bëj me librat? Sepse e pashë atë fizionomi tek ky burrë, mirëpo ishte shumë bujar. Thashë t’i hedh librat.**

**Kur u zgjova, i thashë shërbyesit që të përgatiste kafshën për rrugë dhe ashtu bëri. I hipa kafshës, kalova pranë atij burrit dhe i thashë: “Nëse vjen në Mekë dhe kalon pranë Dhu Tuvasë<sup>16</sup>, atëherë pyet për shtëpinë e Muhamed ibën Idris esh-Shafi’i.”**

---

<sup>16</sup> Luginë pranë Mekës. Në kohën tone njihet me emrin ez-Zahir. Nga libri “el Misbahul munir”.

**Ai m'u përgjigj duke më thënë: "Pse shërbëtori babai tënd jam un?!"**

**Thashë: "Jo!"**

**Pastaj tha: "Ku është ajo që dje kam shpenzuar për ty?"**

**I thashë: "Ç'është ajo?"**

**Tha: "Bleva për ty ushqim për dy dinarë, gjellë për kaq, parfum për tre dinarë, sanë për kafshën tënde, qeraja e dyshekut dhe mbulesës dy dinarë."**

**I thashë shërbyesit që t'ia jepte, pastaj iu drejtova: "Ka mbetur gjë?"**

**Tha: "Qeraja e shtëpisë, sepse kam ngushtuar veten për rehatinë tënde."**

**Shafiu thotë: "U gëzova për ato libra."**

**I thashë burrit: "Ka mbetur gjë?"**

**Më tha: "Ik! Allahu të poshtëroftë! Nuk kam parë njeri më të keq se ti."<sup>17</sup>**

Kjo pat ndikuar tek Shafiu, Allahu e mëshiroftë, saqë kur shërbyesi i sillte ushqim, e pyeste ku e kishte blerë dhe ma përshkruaj. Shërbyesi i tregonte që ishte kështu dhe kështu. Ai thoshte: **"Nuk ha. Këto janë cilësitë më të këqia. Merre dhe hajeni ju, ose kthejeni."**

---

<sup>17</sup> Shiko librin "Adabu esh-Shafi'ij ue menakibuhu" i Ebu Hatim er-Razit fq. 129.

Kjo pat ndikuar tek ai, megjithëse është gabim.

### **Tregimi i tilla historive ka disa dobi:**

1. Ti – o nxënës i dijes – duhet të përpiqesh të lexosh librat e biografive, sepse të mbledhin mendimet, të largojnë mërzinë dhe përtacinë; këto janë në natyrën e njeriut.

Leximi i biografive të dijetarëve dhe të parëve, e gjallërojnë nxënësin dhe e bëjnë të harmonizohet me diturinë, sepse dituria ka gjëra të bukura, ka gjëra të ngatërrueshme, ka të vështira.

Për këtë, kur Zuhriu apo të tjerë përfundonte mësimin, thoshte: **“Na tregoni ndodhitë tuaja, na tregoni poezitë tuaja, sepse zemra ka edhe ithtësi”** apo siç ka thënë.

2. Duhet – o nxënës i dijes – që të përfitosh nga dijetarët e vjetër, megjithëse ti e di që askush nuk është i pagabueshëm.

Mund të gesh në biografinë e dijetarit gjëra të çuditshme, sepse ata janë njerëz. Allahu xhel-le ue ala, me fuqinë dhe urtësinë e Tij, i ka dhënë dijetarëve diçka prej virtyteve të përsosmërisë, në mënyrë që përsosmëria dhe pasimi t’i mbesin vetëm Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem.

Nuk lejohet që dijetarit t’i jepet pozita e Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, që nuk gabon kurrë dhe vepra e tij të jetë njëlloj sikur ajo e Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem. Kjo ka një urtësi nga Allahu xhel-le ue ala, këtu ka Ligj Universal dhe dobi, që njerëzit mos ta teprojnë në lëvdimin e ndonjërit prej dijetarëve, andaj patjetër që dijetari do të ketë rrëshqitje.

I ploti dhe ai që pasohet është dijetari edukues, i cili i mëson të mirën njerëzve, që e përhap udhëzimin mes njerëzve dhe i mëson Sunetin.

Ndërsa gjërat që lidhen me jetën e dijetarit, që mund të jenë të qortueshme, këtyre nuk duhet kushtuar rëndësi, sepse çdo kush e ka diçka që mund të qortohet për të.

Po ta lexosh biografinë e Malikut, Allahu e mëshiroftë, do të gesh gjëra të qortueshme. Kështu edhe në biografinë e Ahmedit, Allahu e mëshiroftë, kështu edhe në biografinë e Ebu Hanifes, Allahu e mëshiroftë, edhe në biografinë e Shafiut, Allahu e mëshiroftë.

Megjithatë, njerëzit janë në pajtim unanim në lëvdatën e këtyre katër imamëve.

Po të shikosh në biografinë e imam Ebu Hanifes, Allahu e mëshiroftë, do të shikosh se në kohën e tij, dikush e mallkonte për disa çështje.

Mirëpo, është bërë e padiskutueshme çështja e lëvdimit të tij dhe se është prej dijetarëve muxhtehidë në Fikh.

Po të lexosh biografitë e dijetarëve në të gjitha kohët, do të shikosh se ata nuk kanë qenë të përkryer, mirëpo patjetër kanë mangësi. Këtë mangësi mos ia përkatëso vetëm atyre, sepse kjo është sprovë nga Allahu xhel-le ue ala, që ta bëjë të qartë se vetëm Ai është i Përkryer, që bëhet e qartë këshilla e këshilluesit dhe të jetë bindja se pasimi i plotë është vetëm për pejgamberët alejhimus-salatu ues-selam, veçanërisht të Pejgamberit tonë Muhamed salauatullahi ue selamuhu alejhi. Secili dijetar thotë: Kjo është çfarë më duket mua dhe Allahu është më i Dituri.



Ndoshta e thotë këtë gjë, ndërkohë që është në kundërshtim me Kuranin dhe Sunetin.

3. Është e mirë që dijetarët në mësimet e tyre të përmendin historitë e bukura, që të marrin frytet e mira prej tyre dhe të paraqesin dobitë në edukimin dhe orientimin e bukur.

Kjo ndikon më shumë në zemër, ndikon më shumë në kthimin tek Allahu xhel-le xhelaluhu dhe në dëshirën për dituri.

Me kaq mjaftohemi.

E lus Allahu xhel-le ue ala që t'ju shpërblejë për dëgjimin tuaj të mirë në heshtje dhe prezantimin tuaj. E lus që t'ju begatojë, të na japë ne dhe ju shumë dobi nga këto mësimet. E lus që t'i shpërblejë të gjithë me shpërblimin më të mirë. E lus që t'i japë sukses prijësve tanë drejt asaj që e kënaq Atë, po ashtu t'i japë udhëzimin dhe suksesin për tek veprat e mira, me të vërtetë Allahu i Lartësuar është Dhurues dhe Bujar.

Salavatet dhe selamet dhe begatitë qofshin për Pejgamberin tonë Muhamed, familjen dhe shokët e tij.<sup>18</sup>

---

<sup>18</sup> Një pjesë e këtij libri e kam përkthyer me datë 01 el Muharrem 1434 h (16 Nëntor 2012 g) në Shkodër dhe është publikuar online. E kam përfunduar përkthimin e plotë dhe rishikimin me datë 16 Ramazan 1441 h (09 Maj 2020 g) në Gent. Përkthyesi.